



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT KRYETARI

Adresa: Rruga: Abdi Toptani nr. 1, Tiranë;

E-mail: klsh.org.al; Web-site: www.klsh.org.al

Nr.1317/5 Prot.

Tiranë, më 30.04.2018

V E N D I M

Nr. 31, Datë 30.04.2018

PËR

AUDITIMIN E USHTRUAR NË DREJTORINË RAJONALE TË ALUIZNI-t QARKU FIER “MBI VLERËSIMIN E AKTIVITETIT EKONOMIKO FINANCIAR, PROCEDURAT E SHQYRTIMIT DHE MIRATIMIT TË KËRKESAVE PËR LEGALIZIMIN E NDËRTIMEVE INFORMALE”, për periudhën nga data 01.01.2015 deri më datën 31.12.2017.

Nga auditimi i ushtruar në Drejtorinë Rajonale të Agjencisë të Legalizimit Urbanizimin dhe Integritimit të Zonave/Ndërtimeve Informale Qarku Fier, rezultoi që veprimtaria e subjektit të audituar, në drejtim të çështjeve që lidhen me vlerësimin e procedurave të shqyrtimit dhe miratimit të kërkesave për legalizimin e objekteve informale, nuk ka qenë plotësisht efektive, rrjedhojë e mangësive procedurale në zbatimin e ligjshmërisë dhe në hartimin e dokumentacionit tekniko ligjor.

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Aseteve dhe Mjedisit, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të mësipërm, Drejtori i Departamentit Juridik dhe Kontrollit të Zbatimit të Standardeve të Auditimit dhe Etikës, si dhe Drejtori i Përgjithshëm nisur nga fakti se nga auditimi janë konstatuar shmangie, në mbështetje të neneve -10, 15, 25 dhe 30, të ligjit nr. 154/2014 miratuar në datën 27.11.2014 -“Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”

V E N D O S A

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit “Për vlerësimin e aktivitetit ekonomiko-financiar, procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të kërkesave për legalizimin e ndërtimeve informale” të ushtruar në Drejtorinë Rajonale të Agjencisë të Legalizimit Urbanizimin dhe Integritimit të Zonave/Ndërtimeve Informale Qarku Fier, sipas programit të auditimit nr. 1317/1 prot., datë 20.12.2017, për periudhën nga data 01.01.2015 deri më 31.12.2017,

II. Të miratoj rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkoj marrjen e masave sa vijon:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Fier nuk ka të administruar (gjurmë auditimi) dokumentacionin shkresor **për skualifikimin e 42 objekteve të ndërtuara në zonën historike, arkeologjike “Bylis” dhe “Apoloni”**, si dhe nuk disponon dokumentacion për informimin e Drejtorisë së Përgjithshme të ALUIZNI-t Tiranë dhe institucionet e vetëqeverisjes vendore në bashkitë Ballsh dhe Fier. Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” i ndryshuar, neni 38 dhe 39 “Përjashtimi nga legalizimi” -si dhe në kundërshtim me VKM 280, datë 01.04.2015 “Për përcaktimin e kritereve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, (- i ndryshuar me VKM 756, datë 26.10.2016, kreu i II pika a, b, c, dhe me VKM nr. 1095, datë 28.12.2015 “Për përcaktimin e rregullave të bashkërendimit të punës, ndërmjet ALUIZNI-t dhe ZQRPP-së, dhe të procedurave apo kufizimeve që zbatohen për efekt të regjistrimit të pasurive të legalizuara”, pika 2).

1.1. Rekomandimi: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Fier të marrë masa dhe të dokumentojë në një regjistër të veçantë objektet informale të ndërtuara në kundërshtim me legjislacionin në fuqi (zona të mbrojtura, arkeologjike, etj.). Të informohet në çdo rast Drejtoria e Përgjithshme e ALUIZNI-t Tiranë, Ministria e Kulturës dhe bashkitë Ballsh dhe Fier, shoqëruar në çdo rast me masa përkatëse për përjashtimin e tyre nga procesi i legalizimit.

Brenda muajit Maj 2018

2. Gjetje nga auditimi: Në 34 rastet “Proces verbal i verifikimit në terren i të dhënave të ndërtimit pa lejë/shtesë në ndërtimin me leje”, pasqyrojnë kufitarët e parcelës ndërtimore të zënë, por nuk janë përcaktuar largësitë e bazës së objektit nga kufijtë e parcelës. Skicat fushore pasqyrojnë përmasat e objektit informal, por nuk kanë të pasqyruara: ndërtimin në raport me kufizimet dhe situatën ndërtimore rreth tij; largësitë nga objekti të kufiri i pronës; largësitë nga pikat ekstreme të pronës dhe objekteve. Këto veprime janë në kundërshtim me manualin “Hartimi dhe paraqitja e materialeve grafike (genplan dhe planimetri) të objektit që legalizohet”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm nr. 846, datë 11.10.2012 “*Për miratimin e Manualit të hartimit dhe paraqitjes së materialeve grafike (genplan dhe planimetri) të objektit që legalizohet*” -i ndryshuar.

2.1. Rekomandimi: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Fier të marrë masa për 34 rastet e konstatuara e në vijim, për të plotësuar “*Proces verbalin e verifikimit në terren të dhënave të ndërtimit pa lejë/shtesës në ndërtimin me leje*”, me largësitë e bazës së objektit nga kufijtë e parcelës ndërtimin në raport me kufizimet dhe situatën ndërtimore rreth tij. Në rastin e mos plotësimit, të bashkëpunojë me Drejtorinë e Përgjithshme të ALUIZNI-t Tiranë dhe t’i kërkojnë Ministrisë së Drejtësisë, që për objektet informale të pajisura me leje legalizimi të fillojë procedurat për shfuqizimin e lejeve të legalizimit të dhëna, në kundërshtim me dispozitat e ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin, integrimin e zonave informale”, i ndryshuar e akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, duke dërguar njoftim zyrtar në ZVRPP Fier.

Deri më datë 30.06.2018

3. Gjetje nga auditimi: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Fier ka pajisur me leje legalizimit **4382 objekte informale, pa u likuiduar parcelat ndërtimore**, këto veprime janë kryer në zbatim VKM-së nr. 954, datë 25.11.2015 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurave dhe të formularit të lejes së legalizimit” i ndryshuar dhe VKM-në nr. 1095, datë 28.12.2015

“Për përcaktimin e rregullave të bashkërendimit të punës, ndërmjet ALUIZNI-t dhe ZQRPP-së, dhe të procedurave apo kufizimeve që zbatohen për efekt të regjistrimit të pasurive të legalizuara”. Për **4382 objektet informale** të pajisur me leje legalizimi, nuk ka përfunduar procesi i legalizimit, pasi nuk kanë dalë VKM-të për të likuiduar detyrimin e parcelave ndërtimore, duke zgjatur procesin e legalizimit jashtë afateve kohore veprime në kundërshtim me nenet 17 (pika 5) dhe 27 të ligjin nr. 9482, datë. 03.04.2006 me ndryshime; me pikën 8 të VKM nr. 280, datë 01.04.2015; Urdhër nr. 37 datë 19.01.2016 për “Matricën e procedurave dhe afateve kohore për shqyrtimin administrativ për legalizim”, pika 6 dhe 7, duke krijuar vonesa në likuidimin e tarifave të parcelave ndërtimore, për vlerën **2,486,400,000 lekë, si e ardhur e munguar në buxhetin e shtetit.**

3.1. Rekomandim: Drejtoria Rajonale ALUIZNI-t Qarku Fier të marrë masa në ndjekje të ecurisë së procesit në Drejtorinë e Përgjithshme të ALUIZNI-t Tiranë të daljes së VKM-së, për kalimin e pronësisë dhe shpronësimin e ish pronarëve mbi mos daljen e VKM për legalizim.

Në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Në 3 raste nga Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Fier nuk është respektuar afati 60 ditor për marrjen e vendimit për kualifikimin ose skuafikimin e praktikës së legalizimit nga data në të cilën është mbajtur procesverbali i konstatimit në terren. Këto veprime janë në kundërshtim me VKM Nr. 280, datë 1.4.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, pika 8, ku përcaktohet: “Drejtoritë e ALUIZNI-t, bazuar në gjendjen faktike në terren, kryejnë procedurat kualifikuese për ndërtimin informal, brenda 60 ditëve nga data e evidentimit faktik në terren (data e “Procesverbalit të evidentimit në terren”). Për kryerjen e këtyre procedurave drejtoritë mbështeten në cilësitë e territorit, të paraqitura grafikisht.

4.1. Rekomandimi: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Fier të marrë masa dhe të përgatisë plane konkrete, të shqyrtojë kërkesat brenda afatit 60 ditor, duke shqyrtuar praktikën e legalizimit dhe përcaktimin e tyre për vijueshmërinë e procesit, apo për skuafikimin e tyre nga procesi i legalizimit si objekte që nuk plotësojnë kërkesat ligjore.

Në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Fier në 2 raste, nuk disponon në dosje dokumentacionin që pasqyron ndryshimet e sipërfaqeve të ndërtimit, kohën e ndërtimit dhe objektet e pa përfunduara. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, neni 10 “Procedura për fillimin e legalizimit të ndërtimeve pa leje”, neni 45/ “Dispozita kalimtare” pika nr. 1 ku përcaktohet: “Për ndërtimet pa leje, të ngritura sipas përcaktimeve të pikave 1 dhe 2 të nenit 2, të këtij ligji, ALUIZNI kryen evidentimin faktik të situatës ndërtimore në terren. Në funksion të kësaj procedure përdoret harta vektor dhe ortofoto e përftuar nga imazhi satelitor, që disponohet nga autoriteti shtetëror përgjegjës. Rregullat e hollësishme, sipas pikës 1 të këtij neni, si dhe përcaktimi i periudhës kohore, brenda së cilës janë ndërtuar objekte pa leje, bëhen me vendim të Këshillit të Ministrave.” si dhe VKM nr. 438, datë 28.06.2006 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave dhe dokumentacionit të zbatueshëm, për të kualifikuar objektet në ndërtim, që legalizohen ose jo” kapitulli i I-rë “Kriteret dhe dokumentacioni i zbatueshëm për legalizimin e ndërtimit pa leje”.

5.1. Rekomandimi: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Fier të marrë masa, për 2 rastet e konstatuara që nuk disponojnë dokumentacionin, duke pasqyruar ndryshimet e sipërfaqeve të ndërtimit, kohën ndërtimit. Për këto objekte, Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Fier të plotësojë dosjet e legalizimit në të kundër në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të ALUIZNI-t Tiranë, t’i kërkojë Ministrisë së Drejtësisë, që për objektet informale të pajisura me leje legalizimi, të fillojë procedurat për shfuqizimin e lejeve të legalizimit, të dhëna në

kundërshtim, me dispozitat e ligjit dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, duke dërguar njoftim zyrtar në ZVRPP Fier.

Brenda muajit Qershorit 2018

6. Gjetje nga auditimi: Në 29 raste legalizimi i objekteve informale, është kryer në kundërshtim me dispozitat e ligjit të legalizimit dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, *pasi:*

- Në 2 raste është kryer legalizim i objekteve pranë kanaleve kulluese dhe brezit mbrojtës të tyre pa marrë më parë konfirmimin nga autoriteti ujtar, për respektimin e distancave.

Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin Nr. 8093, datë 21.03.1996 “Për rezervat ujore” dhe VKM nr. 280, datë 01.04.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm, për të kualifikuar ndërtime pa leje, shtesa anësore dhe /ose në lartësi në ndërtimet me leje”, ndryshuar me VKM nr. 756, datë 26.10.2016, Kreu III, pika 4, germat: “dh” dhe “e”, citohet: “...- është ngritur brenda brezit mbrojtës të sistemeve kryesore të kullimit, të mbrojtura sipas ligjit nr. 8518, datë 30.7.1999, “Për ujitjen dhe kullimin”, të ndryshuar, si dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

-Në 19 raste me sipërfaqe prej 48088 m², sipas dokumentacionit të pronësisë lëshuar nga ZVRPP, parcela ndërtimore e zënë ndodhet e regjistruar në pasurinë e llojit “Arë, ullishte”, zona informale këto të pa miratuara nga KRRTRSH/KKT. Pra, legalizimi është kryer në zona “Territore të tjera”, për të cilat nuk ka gjetur zbatim të neneve 10, 11, dhe 14 të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 dhe VKM nr. 515, datë 13.5.2009 e VKM nr. 589, datë 10.9.2014, “Për përcaktimin e procedurave të evidentimit faktik, në terren, të ndërtimeve pa leje/shtesave në ndërtimet me leje, të organeve e të dokumentacionit, për propozimin e miratimit e zonave informale” gjatë procedurave të legalizimit të objekteve informale”, duke ndryshuar zërin kadastral, regjimin e tokës në llojin e pasurisë “Trrall”

-Në 8 raste është kryer legalizim i objekteve pa respektuar distancat nga rrugët nacionale e urbane, ku sipas dokumentacionit të administruar në dosje: genplani, harta digjitale dhe paraqitur, rezulton se objektet ndodhen në një distancë prej **buzës rrugës me pak se përcaktimet ligjore**. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006, neni 39 “Përrjashtimi nga legalizimi”, VKM nr. 438, date 28.06.2006 i ndryshuar Kreu I pika 2/b dhe i shfuqizuar me VKM nr. 280, datë 1.4.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje” kreu III “Kriteret për legalizimin e ndërtimeve jashtë zonave informale të miratuara”, pika 4/b. Ligjin Nr. 8378, datë 22.07.1998 i ndryshuar “Kodi Rrugor në Republikën e Shqipërisë”, neni 2 “Përcaktime dhe klasifikime rrugësh” dhe neni 4, “Përcaktimi i qendrave të banuara” dhe VKM nr. 153, date 07.04.2000 “Për miratimin e rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor në Republikën e Shqipërisë” neni 25, pika 2.

6.1. Rekomandimi: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Fier në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të ALUIZNI-t Tiranë, t’i kërkojë Ministrisë së Industrisë dhe Infrastrukturës, që për objektet informale të pajisura me leje legalizimi dhe për ato që kanë lidhur kontratat, të fillojë procedurat për shfuqizimin e lejeve të legalizimit të dhëna në kundërshtim, me dispozitat e ligjit dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, duke dërguar njoftim zyrtar në ZVRPP Fier.

Deri më datë 30.06.2018

7. Gjetje nga auditimi: Në Drejtorinë Rajonale të ALUIZNI-t Qarku Fier janë pajisur me leje legalizimi objekte informale në 243 parcela ndërtimore me sipërfaqe totale gjithsej 83066 m² në vlerë totale prej 95,941,144 lekë. Në momentin e auditimit, është konstatuar se deri më datën 27.07.2017 kanë mbaruar procedurat për kompensim e ish pronarëve për 830.1 m² në vlerë totale 10,702,479 lekë, ndërsa për vlerën **85,238,956 lekë** përkatësisht për 82235.9 m² nuk janë kryer procedura për kompensim sipas kërkesave të nenin 34 “Njohja e sipërfaqes së parcelës

ndërtimore për efekt kompensimi”, pika 1 e ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, ligjit nr. 9235, datë 29.7.2004 "Për kthimin dhe kompensimin e pronës", i ndryshuar dhe të Udhëzimit nr. 1451, datë 22.09.2016, pika 9.

7.1. Rekomandimi: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Fier të marrë masa që në vijimin e kryerjes së procesit të legalizimit të objekteve informale, për të gjitha objektet e ndërtuara në pronat e ish pronarëve, për përgatitjen në afatet e caktuara kohore dosjet e ish pronarëve të cilat nuk janë kompensuar për sipërfaqen **82235.9 m²**. (e përkthyer në vlerë është në masën 85,238,956 lekë)

Menjëherë e në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Në Drejtorinë Rajonale të ALUIZNI-t Qarku Fier janë pajisur me leje legalizimi nr. 238802 datë 24.07.2017 proceduesi **V.P.** dhe nr. 247098 datë 31.10.2016 - proceduesi **N.B.** persona me statusin e të verbrit dhe me statusin e KEMPI (kat II), për të cilët në vazhdimin e procedurave të legalizimit është vepruar me përjashtim nga pagesa e parcelës ndërtimore dhe pagesa e taksës së ndikimit në infrastrukturë pa u plotësuar me dokumentacionin e kërkuar veprim në kundërshtim me VKM nr. 488, datë 22.07.2014 kreu i 2, (pika 4).

8.1. Rekomandimi: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Fier të marrë masa për plotësimin e dosjeve të legalizimit me dokumentacionin e kërkuar ligjor për përjashtim e pagesës së taksave.

Menjëherë

9. Gjetje nga auditimi: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Fier në marrjen e vendimeve “Për kualifikimin për legalizim të objektit informal”, ka vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006, nenin 27 “Dokumentacioni tekniko-ligjor për legalizimin e objektit”, pika “ç” –“*vërtetimin për likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për të gjitha rastet, kur subjekti nuk përjashtohet nga pagesa e taksës sipas këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi*”, si dhe me VKM nr. 411, datë 19.05.2010 i ndryshuar “Për kriteret procedurat dhe tipin e formularit të lejes së legalizimit” -Kreu I, pikën 1,c ku përcaktohet –“ *c) për objektin/shtesën pa leje në ndërtime me leje është plotësuar dokumentacioni tekniko-ligjor, i parashikuar në nenet 27 e 37 të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, të ndryshuar.* Në kualifikimin e objekteve informale, ka dërguar pranë Bashkive të Qarkut Fier, vetëm shkresën për llogaritjen e pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë, pa marrë konfirmim mbi pagesën e saj për dalje me vendim kualifikimi, duke krijuar një **mungesë të ardhurash në buxhetin e shtetit në vlerën 324,832,554 lekë.**

9.1. Rekomandimi: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Fier për nevoja të plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor të objekteve me lejeve të legalizimit të lëshuara, t'i kërkojë Njësitë të Vetëqeverisjes Vendore të Qarkut Fier, vërtetimet mbi llogaritjen e likuidimin e Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë në **vlerën prej -324,832,554 lekë, si dhe të kërkojë që të bëhet regjistrimi në sektorin përkatës të kartelës në ZVRPP Mallakastër e Fier, në refuzim të dërgohet shkresë për vendosjen e masës së kufizimit deri në arkëtimin e plotë të detyrimeve të papaguara.**

Brenda muajit Shtator 2018

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të legalizimit të ndërtimeve informale, si dhe evidentimi i sipërfaqeve të lira në pronësi shtet, rezulton se nga ana e Drejtorisë Rajonale të ALUIZNI-t Fier, nuk janë evidentuar dhe janë lënë jashtë procesit të legalizimit sipërfaqe parcelë ndërtimore të zaptuara dhe në posedim nga poseduesit, ku sipas genplaneve, hartës fushore, ortofotos digjitale dhe hartës vektoriale të pronësive paraqitur në autocad (*vënë në dispozicion nga drejtoria e AULIZNI^t, Fier*), vërehet se këto parcela janë zvogëluar me qëllim për të qenë në kufirin deri në 300/500 m²(*brenda/jashtë vijës së verdhë*), për efekt pagese të

vlerës së truallit. Megjithëse në krah të këtyre parcelave ekzistojnë pjesë parcele të pa legalizuara, të cilat janë pjesë përbërëse e parcelës ndërtimore të zaptuar, por që është numërtuar si parcele më vete dhe që të dyja bashkë do të rezultojnë në sipërfaqen e vetë deklaruar nga poseduesit e parcelës së zaptuar, gjë e cila duket dhe nga skica fushore. Plan vendosja e ndërtimit dhe parcelës së zaptuar pasqyruar në genplan me sipërfaqe të zvogëluar, duke lejuar sipërfaqe të ndërmjetme, kufizuar nga kufijtë e sipërfaqes së legalizuar dhe krijimin e parcelave të pa legalizuara brenda parcelave të zëna jo funksionale.

Bazuar në metodën e veçimit dhe matjes me autocad dhe shenjave konvencionale të përdorur në genplan, evidentohen sipërfaqe të pa legalizuara që duhet t'i ishin bashkëngjitur sipërfaqes së legalizuar, pasi nga pamjet me ortofoto, janë lënë jashtë procesit të legalizimit dhe të pamundura për parcelizim për vetë pozicionin gjeografik që ndodhet. Këto veprime janë në kundërshtim me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm nr. 30, datë 15.01.16 "Për mënyrën e hartimit dhe paraqitjes së dokumentacionit teknik (*gen-plan, planimetri*)", i ndryshuar, si dhe shkronja "f" dhe "g" e nenit 3 dhe pika 1 e nenit 17, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", i ndryshuar, ku si rezultat i mos legalizimit të këtyre sipërfaqeve të zaptuara, në zbatim të nenit 19 dhe 20, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 dhe VKM^{së} nr. 1620 datë 26.11.2008, **në 32 raste** është evidentuar një sipërfaqe parcelë ndërtimore brenda/jashtë vijës së verdhë e pa legalizuar prej 3937.9m²(në total), më hollësisht sipas Tabelës - "Sipërfaqe të zaptuara pjesë të parcelave ndërtimore të legalizuara"

- Gjithashtu nga ALUIZNI-t Fier jo vetëm që nuk janë mbajtur evidenca mbi përfaqet e lira në pronësi shtet lënë jashtë procesit të legalizimit dhe të pamundura për parcelizim për vetë pozicionin gjeografik që kanë, por nuk është marrë asnjë masë për të njoftuar dhe bashkëpunuar me institucionet vendore dhe ato kompetente si Bashkitë Fier, Patos, Ballsh dhe Roskovec, vënien në dispozicion të listës së sipërfaqeve të lira, konfirmimin e tyre në pronësi shtet, apo vlerësimin e tyre si troje që përdoren nga qytetarët, pa u taksuar ose për kthim në ambiente publike çlodhëse, lulishte, mungon deklarata noteriale nga individët të cilat pranojnë ose refuzojnë të blejnë truallin sipas çmimit të tregut për pjesën e parcelës të zaptuar e cila është mbi normën ligjore.

10.1. Rekomandim: Drejtoria Rajonale ALUIZNI-t Qarku Fier të marrë masa, për të administruar dhe mbajtur evidencë të saktë dhe në mënyrë të vazhdueshme mbi sipërfaqet e lira në pronësi shtet, lënë jashtë procesit të legalizimit dhe të pamundura për parcelizim për vetë pozicionin gjeografik që kanë, të njoftojë me shkresë institucionet vendore dhe ato kompetente si Bashkitë Fier, Patos, Ballsh dhe Roskovec, duke vënë në dispozicion listën me sipërfaqe të lira, konkretisht për **në 32 raste** është evidentuar një sipërfaqe parcelë ndërtimore brenda/jashtë vijës së verdhë e pa legalizuar prej 3937.9m²(në total).

Brenda muajit Qershor 2018

11. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit "Shërbimi i Evidentimit faktik në terren të ndërtimeve pa leje" viti 2016 me fond limit 16,666,667 lekë pa TVSH, Njësia e prokurimit:

- nuk ka kryer funksionin e saj në përputhje me Ligjin nr. nr.9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, neni 1, pika 2(b), pika 2(dh), VKM nr.914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, neni 57, pika 2, dhe VKM nr. 860, datë 10.12.2014 "Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim" i ndryshuar, pika 2 ku thuhet se: "...Tarifa e shërbimit për legalizim, për ndërtimet pa leje me funksion social-ekonomik, si dhe për objektet e dyta, në kuptim të nenit 25, të Ligjit 9482, datë 03.04.2006, "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje" të ndryshuar është 8,000 lekë për çdo kat ndërtimi.

- ka vendosur si kriter, dorëzimin e certifikatës ISO 14001:2004 "Për implementimin e sistemit të menaxhimit të Mjedisit", kriter i cili nuk ka lidhje me objektin e kontratës pasi operatori

fitues do të bëj evidentimin faktik në terren dhe jo konstatimin e faktit nëse ndërtimet pa leje kanë ndikim të drejtpërdrejtë në mjedis ose jo.

11.1.Rekomandim: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI Fier, Njësia e Prokurimit për çdo procedurë tenderimi: të marrë masa dhe të zbatoj aktet ligjore e nënligjore në fuqi, duke stimuluar transparencën dhe konkurrencën si dhe të zbatojë me përpikmëri dhe rigorozitet aktet ligjore e nënligjore në fuqi, duke vendosur kritere të cilat të jenë në raport të drejtë për drejtë me objektin e prokurimit

Në vijimësi

B. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET(3E) TË FONDEVE PUBLIKE.

1. Gjetje nga Auditimi: Për procedurën e prokurimit “*Shërbimi i Evidentimit faktik në terren të ndërtimeve pa leje*” viti 2016 u konstatua se me fondin limit prej 20,000,000lekë, duke marrë për bazë çmimin e përcaktuara nga VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim” i ndryshuar, pika 2 ku thuhet se: ...*Tarifa e shërbimit për legalizim, për ndërtimet pa leje me funksion social-ekonomik, si dhe për objektet e dyta, në kuptim të nenit 25, të Ligjit 9482, datë 03.04.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” të ndryshuar është 8,000 lekë për çdo kat ndërtimi. Njësia e Prokurimit në dokumentet e tenderit duhet të përcaktonte matjet për minimum 2500 kate (20,000,000 lekë / 8,000 lekë/kati). Nga dokumentacioni i tenderit kjo Njësi ka prokuruar vetëm 2208 kate duke marrë si çmim bazë ofertën më të ulët të ofruar nga BOE fitues.*

Nisur nga sa më sipër me fondin e vënë në dispozicion prej 20,000,000 lekë janë prokuruar 292 kate më pak **me një efekt negativ financiar prej 2,336,000 lekë** (2500 kate – 2208 kate = 292 kate) (292 kate x 8,000 lekë/kati = 2,336,000 lekë), veprim i cili bie në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, neni 1, “Objekti dhe qëllimi”, pika 2, germa b, dh, neni 2 “Parimet e përzgjedhjes”, germa b ,VKM nr. 914,datë 29.12.2014 " Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, neni 57, pika 2, -VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim” i ndryshuar, pika 2.

1.1. Rekomandimi: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Fier, të marrë masa, e të analizojë me grup pune të veçantë, duke nxjerrë shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për mos përdorimin me efektivitet, economicitet dhe eficientë të fondeve publike, për procedurën e prokurimit me efekte negative në përdorimin e fondeve publike, duke vënë theksin në rritjen e vlerës së shtuar nga përdorimi i fondeve publike në shërbim të komunitetit.

Menjëherë

C. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në Kreu IV, neni 11 germa “d” dhe “e” dhe nenet 37, 141, dhe 153 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjin nr. 8085, datë 13.03.1996, ligjin nr. 9125, datë 29.07.2003 dhe ligjin nr. 136/2015, ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, si dhe në kontratën individuale të punës **ti kërkohet Drejtorit të Përgjithshëm të ALUIZNI-t dhe Drejtorit Rajonal të ALUIZNI-t Fier**, vlerësimin e shkallës së përgjegjësisë për çdo punonjës të cituar më poshtë dhe marrjen e masave disiplinore nga “**Vërejtje me shkrim**” deri në “**Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna**”, për këta punonjës:

I. Masa “Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna”, për 6 punonjës si më poshtë:

- 1. E.B. Drejtor i Drejtorisë Rajonale ALUIZNI Qarku Fier**
- 2. R.H. Përgjegjës Sektorit të Legalizimit**
- 3. K.M. Përgjegjës Sektorit të Kalimit të Pronësisë**

Për të metat e mangësi të konstatuara, në zbatimin e procedurave ligjore e nënligjore në pranimin dhe administrimin e dokumentacionit tekniko ligjor në miratimin e lejeve të legalizimit:

- Nga Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Fier nuk ka të administruar (gjurmë auditimi) dokumentacionin shkresor për skuaifikimin e **42 objekteve të ndërtuara në zonën historike, arkeologjike “Bylis” dhe “Apoloni”**, si dhe nuk disponon dokumentacion për informimin e Drejtorisë së Përgjithshme të ALUIZNI-t Tiranë dhe institucionet e vetëqeverisjes vendore në Bashkitë Ballsh dhe Fier. Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9482 në neni 38 dhe 39 “Përfundimi nga legalizimi” -si dhe në kundërshtim me VKM 280, datë 01.04.2015 (i ndryshuar me VKM 756, datë 26.10.2016) kreu i II pika a, b, c, dhe me VKM nr. 1095, datë 28.12.2015 pika 2

- Në Drejtorinë Rajonale të ALUIZNI-t Qarku Fier, për periudhën objekt auditimi janë pajisur me leje legalizimit vetëm objektin, **pa u likuiduar parcelat ndërtimore 4382** objekte informale në zbatim VKM-në nr. 954, datë 25.11.2015 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurave dhe të formularit të lejes së legalizimit” i ndryshuar dhe VKM-në nr. 1095, datë 28.12.2015 “Për përcaktimin e rregullave të bashkërendimit të punës, ndërmjet ALUIZNI-t dhe ZQRPP-së, dhe të procedurave apo kufizimeve që zbatohen për efekt të regjistrimit të pasurive të legalizuara”. Për 4382 objektet informale të pajisur me leje legalizimi nuk ka përfunduar procesi i legalizimit, nuk kanë dalë VKM-të për të likuiduar detyrimin e parcelave ndërtimore, duke zgjatur procesin e legalizimit jashtë afateve kohore veprime në kundërshtim me nenet 17 (pika 5) dhe 27 të ligjin nr. 9482, datë. 03.04.2006 me ndryshime; me pikën 8 të VKM nr. 280, datë 01.04.2015; Urdhrin nr. 37 datë 19.01.2016 për “Matricën e procedurave dhe afateve kohore për shqyrtimin administrativ për legalizim”, Pika 6 dhe 7, duke krijuar vonesa në likuidimin e tarifave të parcelave ndërtimore, për vlerën **2,486,400,000** (lekë + bono privatizimi), si e ardhur e munguar në buxhetin e shtetit

- Në 3 raste nga Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Fier nuk është respektuar afati 60 ditor për marrjen e vendimit për kualifikimin ose skuaifikimin e praktikës së legalizimit nga data në të cilën është mbajtur procesverbali i konstatimit në terren. Këto veprime janë në kundërshtim me VKM Nr. 280, datë 1.4.2015 “Për përcaktimin e kritereve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, pika 8, ku citohet: “Drejtoritë e ALUIZNI-t, bazuar në gjendjen faktike në terren, kryejnë procedurat kualifikuese për ndërtimin informal, brenda 60 ditëve nga data e evidentimit faktik në terren (data e “Procesverbalit të evidentimit në terren”). Për kryerjen e këtyre procedurave drejtoritë mbështeten në cilësitë e territorit, të paraqitura grafikisht

- Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Fier në 2 raste, nuk disponon në dosje dokumentacionin që pasqyron ndryshimet e sipërfaqeve të ndërtimit, kohën e ndërtimit dhe objektet e pa përfunduara. Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, neni 10 “Procedura për fillimin e legalizimit të ndërtimeve pa leje”, neni 45/ “Dispozita kalimtare” pika nr. 1 ku përcaktohet: “Për ndërtimet pa leje, të ngritura sipas përcaktimeve të pikave 1 dhe 2 të nenit 2, të këtij ligji, ALUIZNI kryen evidentimin faktik të situatës ndërtimore në terren. Në funksion të kësaj procedure përdoret harta vektor dhe ortofoto e përfutur nga imazhi satelitor, që disponohet nga autoriteti shtetëror përgjegjës. Rregullat e hollësishme, sipas pikës 1 të këtij neni, si dhe përcaktimi i periudhës kohore, brenda së cilës janë ndërtuar objekte pa leje, bëhen

me vendim të Këshillit të Ministrave.” si dhe VKM nr. 438, datë 28.06.2006 *"Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave dhe dokumentacionit të zbatueshëm, për të kualifikuar objektet në ndërtim, që legalizohen ose jo"* kapitulli i I-rë *"Kriteret dhe dokumentacioni i zbatueshëm për legalizimin e ndërtimit pa leje"*

- Në -29 raste legalizimi i objekteve informale, është kryer në kundërshtim me dispozitat e ligjit të legalizimit dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, *pasi*:

- Në 2 raste është kryer legalizim i objekteve pranë kanaleve kulluese dhe brezit mbrojtës të tyre pa marrë më parë konfirmimin nga autoriteti ujtar, për respektimin e distancave.

Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin -Nr. 8093, datë 21.03.1996 *"Për rezervat ujore"* dhe VKM nr. 280, datë 01.04.2015 *"Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm, për të kualifikuar ndërtime pa leje, shtesa anësore dhe /ose në lartësi në ndërtimet me leje"*, ndryshuar me VKM nr. 756, datë 26.10.2016, Kreu III, pika 4, geramat: "dh" dhe "e", citohet: "...- është ngritur brenda brezit mbrojtës të sistemeve kryesore të kullimit, të mbrojtura sipas ligjit nr. 8518, datë 30.7.1999, *"Për ujtitjen dhe kullimin"*, të ndryshuar, si dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

-Në 19 raste me sipërfaqe prej 48088 m², sipas dokumentacionit të pronësisë lëshuar nga ZVRPP, parcela ndërtimore e zënë ndodhet e regjistruar në pasurinë e llojit "Arë, ullishte", zona informale këto të pa miratuara nga KRRTRSH/KKT. Pra legalizimi është kryer në zona "Territore të tjera", për të cilat nuk ka gjetur zbatim të neneve 10, 11, 14, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006, të ndryshuar dhe VKM nr. 515, datë 13.5.2009 e VKM nr. 589, datë 10.9.2014, *"Për përcaktimin e procedurave të evidentimit faktik, në terren, të ndërtimeve pa leje/shtesave në ndërtimet me leje, të organeve e të dokumentacionit, për propozimin e miratimit e zonave informale"* gjatë procedurave të legalizimit të objekteve informale", duke ndryshuar zërin kadastral, regjimin e tokës në llojin e pasurisë "Truall"

-Në 8 raste është kryer legalizim i objekteve pa respektuar distancat nga rrugët nacionale e urbane, ku sipas dokumentacionit të administruar në dosje: genplani, harta digjitale dhe paraqitur, rezulton se objektet ndodhen në një distancë prej buzës rrugës me pak se përcaktimet ligjore. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 *"Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje"*, të ndryshuar, neni 39 *"Përjashtimi nga legalizimi"*, VKM nr. 438, date 28.06.2006 i ndryshuar Kreu I pika 2/b dhe i shfuqizuar me VKM nr. 280, datë 1.4.2015 *"Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje"* kreu III *"Kriteret për legalizimin e ndërtimeve jashtë zonave informale të miratuara"*, pika 4/b. Ligjin -Nr. 8378, datë 22.07.1998 i ndryshuar *"Kodi Rrugor në Republikën e Shqipërisë"*, neni 2 *"Përcaktime dhe klasifikime rrugësh"* dhe neni 4, *"Përcaktimi i qendrave të banuara"* -dhe VKM nr. 153, date 07.04.2000 *"Për miratimin e rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor në Republikën e Shqipërisë"* neni 25, pika 2

- Nga auditimi i procedurave të legalizimit të ndërtimeve informale si dhe evidentimi i sipërfaqeve të lira në pronësi shtet, rezulton se nga ana e Drejtorisë Rajonale të ALUIZNI-t Fier, nuk janë evidentuar dhe janë lënë jashtë procesit të legalizimit sipërfaqe parcelë ndërtimore të zaptuara dhe në posedim nga poseduesit, ku sipas genplaneve, hartës fushore, ortofotos digjitale dhe hartës vektoriale të pronësive paraqitur në autocad (*vënë në dispozicion nga drejtoria e AULIZNI^t, Fier*), bie në sy se këto parcela janë zvogëluar me qëllim për të qenë në kufirin deri në 300/500 m²(*brenda/jashtë vijës së verdhë*), për efekt pagese të vlerës së truallit. Megjithëse në krah të këtyre parcelave ekzistojnë pjesë parcele të pa legalizuara, të cilat janë pjesë përbërëse e parcelës ndërtimore të zaptuar, por që është numërtuar si parcele më vete dhe që të dyja bashkë do të rezultonin në sipërfaqen e vetë deklaruar nga poseduesit e parcelës së zaptuar, gjë e cila duket dhe nga skica fushore. Plan vendosja e ndërtimit dhe parcelës së zaptuar pasqyruar në genplan me sipërfaqe të zvogëluar, duke lejuar sipërfaqe të ndërmjetme, kufizuar nga kufijtë e sipërfaqes së legalizuar dhe krijimin e parcelave të pa legalizuara brenda parcelave të zëna jo funksionale.

Bazuar në metodën e veçimit dhe matjes me autocad dhe shenjave konvencionale të përdorur në genplan, evidentohen sipërfaqe e pa legalizuara që duhet t'i ishin bashkëngjitur sipërfaqes së legalizuar, pasi nga pamjet me ortofoto, janë lënë jashtë procesit të legalizimit dhe të pamundura për parcelizim për vetë pozicionin gjeografik që ndodhet. Këto veprime janë në kundërshtim me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm nr. 30, datë 15.01.16 "Për mënyrën e hartimit dhe paraqitjes së dokumentacionit teknik (*gen-plan, planimetri*)", i ndryshuar, si dhe shkronja "f" dhe "g" e nenit 3 dhe pika 1 e nenit 17, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 "*Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje*", i ndryshuar, ku si rezultat i mos legalizimit të këtyre sipërfaqeve të zaptuara, në zbatim të nenit 19 dhe 20, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 dhe VKM^{së} nr. 1620 datë 26.11.2008, në 32 raste është evidentuar një sipërfaqe parcelë ndërtimore *brenda/jashtë vijës së verdhë* e pa legalizuar prej 3937.9m²(në total), me një vlerë tarife e cila sipas vlerës së truallit me çmim tregu referuar zonave kadastrale llogaritet në shumën totale prej 38,357,252.7 lekë, duke shkaktuar mungesë të ardhurash në buxhetin të shtetit për fondin e kompensimit të ish-pronarëve, më hollësisht sipas Tabelës - "*Sipërfaqe të zaptuara pjesë të parcelave ndërtimore të legalizuara*"

- Gjithashtu nga ALUIZNI-t Fier jo vetëm që nuk janë mbajtur evidenca mbi përfaqet e lira në pronësi shtet lënë jashtë procesit të legalizimit dhe të pamundura për parcelizim për vetë pozicionin gjeografik që kanë, por nuk është marrë asnjë masë për të njoftuar dhe bashkëpunuar me institucionet vendore dhe ato kompetente si Bashkitë Fier, Patos, Ballsh dhe Roskovec, vënien në dispozicion të listës së sipërfaqeve të lira, konfirmimin e tyre në pronësi shtet, apo vlerësimin e tyre si troje që përdoren nga qytetarët, pa u taksuar ose për kthim në ambiente publike çlodhëse, lulishte, mungon deklarata noteriale nga individët të cilat pranojnë ose refuzojnë të blejnë truallin sipas çmimit të tregut për pjesën e parcelës të zaptuar e cila është mbi normën ligjore

4. A. K. me detyrë Jurist në cilësinë e anëtarit të Njësisë së prokurimit

5. E. XH. në cilësinë e specialistes së Financës, dhe anëtares së NJ.P.

6. S. LL. në cilësinë e anëtarit të Njësisë së Prokurimit

Për të metat e mangësi të konstatuara, në zbatimin e procedurave ligjore në prokurimin e fondeve publike në tenderimin e - "*Shërbimi i Evidentimit faktik në terren të ndërtimeve pa leje*" viti 2016 me fond limit 16,666,667lekë pa TVSH dhe 20,000,000lekë me TVSH.

-Njësia e prokurimit nuk ka kryer funksionin e saj në përputhje me Ligjin nr. nr.9643,datë 20.11.2006 -"*Për Prokurimin Publik*" i ndryshuar, neni 1, pika 2(b), pika 2(dh), VKM nr.914,datë 29.12.2014 " Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, neni 57, pika 2, dhe VKM nr. 860,datë 10.12.2014 "Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim" i ndryshuar, pika 2 ku thuhet se:- *...Tarifa e shërbimit për legalizim, për ndërtimet pa leje me funksion social-ekonomik, si dhe për objektet e dyta, në kuptim të nenit 25, të Ligjit 9482, datë 03.04.2006, "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje" të ndryshuar është 8,000 lekë për çdo kat ndërtimi*

-Njësia e Prokurimit ka vendosur si kriter, dorëzimin e certifikatës ISO 14001:2004 "*Për implementimin e sistemit të menaxhimit të Mjedisit*", kriter i cili nuk ka lidhje me objektin e kontratës pasi operatori fitues do të bëjë evidentimin faktik në terren dhe jo konstatimin e faktit nëse ndërtimet pa leje kanë ndikim të drejtpërdrejtë në mjedis ose jo.

-Njësia e Prokurimit në dokumentet e tenderit duhet të përcaktonte matjet për minimum 2500 kat (20,000,000 lekë / 8,000 lekë/kati) duke marrë për bazë çmimin e përcaktuar nga VKM nr. 860, datë 10.12.2014 "Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim" i ndryshuar, pika 2 ku thuhet se : *...Tarifa e shërbimit për legalizim, për ndërtimet pa leje me funksion social-ekonomik, si dhe për objektet e dyta, në kuptim të nenit 25, të Ligjit 9482, datë 03.04.2006, "Për*

legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” të ndryshuar është 8,000 lekë për çdo kat ndërtimi..

Nga dokumentacioni i tenderit kjo Njësi ka prokuruar vetëm 2208kt duke marrë si çmim baze ofertën më të ulët të ofruar nga BOE fitues. Nisur nga sa më sipër me fondin e vënë në dispozicion prej 20,000,000 lekë me TVSH janë prokuruar 292 kate më pak **me një efekt negativ financiar prej 2,336,000 lekë** (2500 kate – 2208 kate = 292 kate) (292kate x 8,000 lekë/kati = 2,336,000 lekë) , veprim i cili bie në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, neni 1, “Objekti dhe qëllimi”, pika 2, germa b, dh, neni 2 “Parimet e përzgjedhjes”, germa “b” , VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 57, pika 2, -VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim” i ndryshuar, pika 2

II- Masa “Vërejtje me shkrim” për 6 punonjës si më poshtë:

- 1. E. XH. me detyrë specialist,**
- 2. A. DH. me detyrë specialist,**
- 3. E. L. me detyrë specialist,**
- 4. A. A. me detyrë specialist,**
- 5. A. DH. me detyrë specialist,**
- 6. L. M. me detyrë specialist terreni.**

Në cilësinë e specialisteve dhe inspektorë të terreni, për të metat e mangësi të konstatuara, në zbatimin e procedurave ligjore e nënligjore në pranimin dhe administrimin e dokumentacionit tekniko ligjor në miratimin e lejeve të legalizimit, pasi:

- Në 34 rastet “Proces verbal i verifikimit në terren i të dhënave të ndërtimit pa lejë/shtesë në ndërtimin me leje”, pasqyron kufitarët e parcelës ndërtimore të zënë, por nuk janë përcaktuar largësitë e bazës së objektit nga kufijtë e parcelës. Skicat fushore pasqyrojnë përmasat e objektit informal, por nuk kanë të pasqyruara: ndërtimin në raport me kufizimet dhe situatën ndërtimore rreth tij; largësitë nga objekti te kufiri i pronës; largësitë nga pikat ekstreme të pronës dhe objekteve. Veprime në kundërshtim me manualin “Hartimi dhe paraqitja e materialeve grafike (genplan dhe planimetri) të objektit që legalizohet”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm nr. 846, datë 11.10.2012 “Për miratimin e Manualit të hartimit dhe paraqitjes së materialeve grafike (genplan dhe planimetri) të objektit që legalizohet” i ndryshuar

- Nga auditimi i procedurave të legalizimit të ndërtimeve informale si dhe evidentimi i sipërfaqeve të lira në pronësi shtet, rezulton se nga ana e Drejtorisë Rajonale të ALUIZNI-t Fier, nuk janë evidentuar dhe janë lënë jashtë procesit të legalizimit sipërfaqe parcelë ndërtimore të zaptuara dhe në posedim nga poseduesit, ku sipas genplaneve, hartës fushore, ortofotos digjitale dhe hartës vektoriale të pronësive paraqitur në autocad (*vënë në dispozicion nga drejtoria e AULIZNI^t, Fier*), bie në sy se këto parcela janë zvogëluar me qëllim për të qenë në kufirin deri në 300/500 m² (*brenda/jashtë vijës së verdhë*), për efekt pagese të vlerës së truallit. Megjithëse në krah të këtyre parcelave ekzistojnë pjesë parcele të pa legalizuara, të cilat janë pjesë përbërëse e parcelës ndërtimore të zaptuar, por që është numërtuar si parcele më vete dhe që të dyja bashkë do të rezultonin në sipërfaqen e vetë deklaruar nga poseduesit e parcelës së zaptuar, gjë e cila duket dhe nga skica fushore. Plan vendosja e ndërtimit dhe parcelës së zaptuar pasqyruar në genplan me sipërfaqe të zvogëluar, duke lejuar sipërfaqe të ndërmjetme, kufizuar nga kufijtë e sipërfaqes së legalizuar dhe krijimin e parcelave të pa legalizuara brenda parcelave të zëna jo funksionale.

Bazuar në metodën e veçimit dhe matjes me autocad dhe shenjave konvencionale të përdorur në genplan, evidentohen sipërfaqe e pa legalizuara që duhet t’i ishin bashkëngjitur sipërfaqes së legalizuar, pasi nga pamjet me ortofoto, janë lënë jashtë procesit të legalizimit dhe të

pamundura për parcelizim për vetë pozicionin gjeografik që ndodhet. Këto veprime janë në kundërshtim me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm nr. 30, datë 15.01.16 “Për mënyrën e hartimit dhe paraqitjes së dokumentacionit teknik (*gen-plan, planimetri*)”, i ndryshuar, si dhe shkronja “f” dhe “g” e nenit 3 dhe pika 1 e nenit 17, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, ku si rezultat i mos legalizimit të këtyre sipërfaqeve të zaptuara, në zbatim të nenit 19 dhe 20, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 dhe VKM^{së} nr. 1620 datë 26.11.2008, në 32 raste është evidentuar një sipërfaqe parcelë ndërtimore *brenda/jashtë vijës së verdhë* e pa legalizuar prej 3937.9m²(në total), me një vlerë tarife e cila sipas vlerës së truallit me çmim tregu referuar zonave kadastrale llogaritet në shumën totale prej 38.357.252.7 lekë, duke shkaktuar mungesë të ardhurash në buxhetin të shtetit për fondin e kompensimit të ish-pronarëve, më hollësisht sipas Tabelës - “*Sipërfaqe të zaptuara pjesë të parcelave ndërtimore të legalizuara*”

- Nga ALUIZNI-t Fier jo vetëm që nuk janë mbajtur evidenca mbi përfaqet e lira në pronësi shtet lënë jashtë procesit të legalizimit dhe të pamundura për parcelizim për vetë pozicionin gjeografik që kanë, por nuk është marrë asnjë masë për të njoftuar dhe bashkëpunuar me institucionet vendore dhe ato kompetente si Bashkitë Fier, Patos, Ballsh dhe Roskovec, vënien në dispozicion të listës së sipërfaqeve të lira, konfirmimin e tyre në pronësi shtet, apo vlerësimin e tyre si troje që përdoren nga qytetarët, pa u taksuar ose për kthim në ambiente publike çlodhëse, lulishte, mungon deklarata noteriale nga individët të cilat pranojnë ose refuzojnë të blejnë truallin sipas çmimit të tregut për pjesën e parcelës të zaptuar e cila është mbi normën ligjore

- Nga ALUIZNI-t Fier jo vetëm që nuk janë mbajtur evidenca mbi përfaqet e lira në pronësi shtet lënë jashtë procesit të legalizimit dhe të pamundura për parcelizim për vetë pozicionin gjeografik që kanë, por nuk është marrë asnjë masë për të njoftuar dhe bashkëpunuar me institucionet vendore dhe ato kompetente si Bashkitë Fier, Ballsh, Patos e Roskovec vënien në dispozicion të listës së sipërfaqeve të lira, konfirmimin e tyre në pronësi shtet, apo vlerësimin e tyre si troje që përdoren nga qytetarët, pa u taksuar ose për kthim në ambiente publike çlodhëse, lulishte, mungon deklarata noteriale nga individët të cilat pranojnë ose refuzojnë të blejnë truallin sipas çmimit të tregut për pjesën e parcelës të zaptuar e cila është mbi normën ligjore materialeve grafike (*genplan dhe planimetri*) të objektit që legalizohet” i ndryshuar.

III. Për punonjësit e larguar dhe që nuk kanë adresim institucional.

Për 23 ish punonjësit, edhe sepse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personat e sipërpërmendur nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien e zbatimit e tyre. Nga ana jonë në bazë të shkeljeve të konstatuara masa disiplinore, do të ishte nga “**Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna**” deri në “**Largim nga Puna (zgjidhje e kontratës)**”, përkatësisht: E. F., L. T., A. S., M. B., G. D., K. K., H. P., B. C., A. M., K. A., G. H., R. P., Gj. C., M. S., E. M., F. C., G. A., M. P., J. G., O. T., E. D., E. Ç. dhe J. D.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Administrimit të Aseteve dhe Mjedisit dhe Departamenti Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R